



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1161/8 prot.

Datë 05.05.2026

V E N D I M

Nr. 584/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.05.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-76061-02-12-2026, me objekt: “Loti 2: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Tiranë”, me fond limit 23,531,592 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit

Ankimues: Operatori ekonomik “NRG” SHPK, me NIPT L13426006B, dhe me adresë: Rruga Eduard Mano, Pallati 10, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina nr.6/337(në krah të Gjykatës së Lartë) Tiranë

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “Egian Med” SHPK, me NIPT L71715003C, dhe me adresë: Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajës, Godina “Condor Centre”, Kati 4, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraparak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik abkimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 13.02.2026 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-76061-02-12-2026, me objekt: “Loti 2: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Tiranë”, me fond limit 23,531,592 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 27.03.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 31.03.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “NRG” sh.p.k	22,511,376 lekë	skualifikuar
2. “Egian Med” shpk	22,846,944 lekë	kualifikuar
3. “Loerma” SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike	
4. “Alpest” SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike	

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik me datë 08.04.2026, rezulton se është publikuar në SPE Njoftimi i Fituesit Paraparak.

II.5. Në datën 16.04.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6542 dhe nr. 1161/1/2026 prot., datë 16.04.2026 e operatorit ekonomik “NRG” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht operatori ekonomik ankimies pretendon:

“[...]

Së pari në lidhje me produktin larvacid të përdorur dhe përbërjen e tij:

Në kuadrin e procedurës së prokurimit publik me objekt Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane , analiza e përputhshmërisë së ofertave me specifikimet teknike duhet të bazohet në natyrën detyruese të këtyre të fundit, të cilat, në përputhje me ligjin nr. 162/2020 Për prokurimin publik dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, përbëjnë standardin minimal të performancës që çdo ofertë duhet të përmbushë. Specifikimet teknike nuk kanë karakter deklarativ apo orientues, por janë elemente thelbësore që lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe që përcaktojnë aftësinë reale të ofertës për të përmbushur qëllimin e prokurimit. Në këtë kuptim, çdo mospërmbushje e një kërkesë teknike thelbësore e bën ofertën juridikisht të papranueshme dhe imponon detyrimin për skualifikim pa asnjë hapësirë diskrecioni nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Në rastin konkret, Dokumentet Standarde të Tenderit përcaktojnë në mënyrë eksplicite se shërbimi i dezinfektimit duhet të garantojë kontrollin e mushkonjave në zonat urbane dhe bregdetare, duke përfshirë domosdoshmërisht tre gjini biologjike: Aedes, Culex dhe Anopheles. Kjo kërkesë nuk përbën një element teknik dytësor, por një kriter funksional të lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, duke qenë se secila prej këtyre gjinive paraqet rëndësi specifike në kontekstin epidemiologjik dhe mjedisor të zonave ku do të kryhet ndërhyrja. Në veçanti, kontrolli i gjinisë Anopheles ka rëndësi të veçantë në zonat bregdetare, për shkak të rolit të saj si vektor i sëmundjeve me rëndësi për shëndetin publik, çka e bën kërkesën për efikasitet ndaj kësaj gjinie një element thelbësor të performancës së shërbimit.

Në Dokumentet Standarde të Tenderit dhe specifikisht në shtojcën 6 Formulari i Specifikimeve Teknike është përcaktuar në mënyrë të detajuar se larvacidet të cilat do të

përdoren duhet të trajtojnë larvat e mushkonjave të cilat i përkasin kategorive Aedes, Culex, Anopheles.

Cituar kjo sa më sipër sipas paragrafit Në zonat urbane shqetësim përbëjnë kryesisht mushkonjat e gjinisë Aedes dhe Culex të cilat njihen edhe për rolin e tyre vektorial në transmetimin e patogjenëve si virusin e Nilit Perëndimor (ËNV), virusin Chikungunja, Dengue, ZIKA etj. ndërsa në zonat bregdetare gjithashtu edhe ato të gjinisë Anopheles (vektor të malaries), Aedes (Ochlerotatus) që shkaktojnë shumë bezdisje me pickimet e tyre sidomos në muzg, etj.

Shoqëria Egian Med sh.p.k ka paraqitur në këtë procedurë produktin larvicid AQUABAC DF3000, të pajisur me Akt Autorizimi nr. 2, datë 09.02.2026, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në analizë të cilësisë së këtij produkti, rezulton se produkti përmban si lëndë vepruese bacillus thuringiensis subsp. israelensis (Bti), serotipi H-14, shtami BMP-144, i deklaruar si teknikisht ekuivalent me shtamin AM65-52.

Referuar Ligjit nr. 95/2015 Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik , i ndryshuar me Ligjin nr. 76/2025 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.95/2015 për produktet biocide, ne Neni 8, pika 2, përcakton Autorizimi për vendosjen në treg të produkteve biocide lëshohet për: a) produkte të prodhuara në vend, por të autorizuara paraprakisht në një nga vendet e Bashkimit Evropian; b) produkte të importuara, të autorizuara paraprakisht në një nga vendet e Bashkimit Evropian, pavarësisht vendit të origjinës. Pra bazuar në legjislacionin e sipërcituar si dhe në Rregulloren (BE) nr. 528/2012 për produktet biocide, autorizimi i një produkti biocid në një shtet

anëtar të Bashkimit Evropian dhe regjistrimi i tij në sistemin përkatës rregullator përbëjnë kusht paraprak për njohjen dhe autorizimin e tij në vende të tjera që zbatojnë këtë kuadër, përfshirë Republikën e Shqipërisë.

Në këtë kuptim, një produkt biocid mund të autorizohet në Shqipëri vetëm nëse:

- është paraprakisht i autorizuar në një shtet të Bashkimit Evropian; dhe
- është i regjistruar dhe i vlerësuar në kuadrin e European Chemicals Agency (ECHA).

ECHA si një agjenci e Bashkimit Evropian është përgjegjëse për administrimin dhe zbatimin e legjislacionit evropian për kimikatet dhe produktet biocide, duke përfshirë vlerësimin e substancave aktive, autorizimin e produkteve dhe publikimin e të dhënave teknike dhe rregullatore përkatëse.

Në këtë kuptim regjistrimi dhe autorizimi i një produkti në sistemin e ECHA përbëjnë bazën ligjore dhe teknike mbi të cilën mbështetet edhe autorizimi i tij në Republikën e Shqipërisë.

Megjithatë, nga KPP nuk po kërkohet të kontrollojë ligjshmërinë e autorizimit administrative biocid, i cili nga ana jonë do të bëhet objekt kundërshtimi në gjykatë, por të verifikojë nëse dokumentacioni teknik i produktit të autorizuar provon përputhjen e tij me kërkesat specifike të tenderit.

Nga analiza e dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik i kualifikuar rezulton se produktet konkrete të tipit AQUABAC nuk përmbushin kërkesën thelbësore që lidhet me kontrollin mushkonjave të gjinisë Anopheles. Dokumentacioni teknik që përfshinë të dhënat e përditësuara të publikuara në databazat ndërkombëtare dhe dokumentet përkatëse të autorizimit të AQUABAC, evidenton mungesën e provave të vlefshme shkencore që demonstrojnë mungesën e efikasitetit të produktit kundër larvave të gjinisë Anopheles. Në mënyrë të veçantë konstatohet se nuk ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme për të mbështetur këto pretendim, dhe për rrjedhojë kjo gjini nuk është përfshirë tek organizmat target të

autorizua të produktit. Ky fakt ka rëndësi vendimtare, pasi mungesa e provës së efikasitetit nuk përbën një mangësi formale, por një mungesë reale të përputhshmërisë teknike me kërkesat e tenderit.

Në këtë kontekst, duhet theksuar se dokumenti i karakteristikave të produktit (SPC) përbën referencën ligjore dhe teknike mbi të cilën përcaktohen kushtet e përdorimit dhe spektri i veprimit të një produkti biocid. Sipas standardeve ndërkombëtare të rregullimit të produkteve biocide, çdo pretendim për efikasitetin duhet të jetë i mbështetur në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë dokument dhe në të dhënat shkencore përkatëse. Për rrjedhojë, mungesa e përfshirjes së gjinisë *Anopheles* në SPC nuk është thjesht një mungesë deklarative, por një kufizim juridik që ndalon përdorimin e produktit për këtë qëllim. Në këto kushte, përdorimi i produktit për kontrollin e kësaj gjinie jo vetëm që nuk është i provuar, por nuk është as i autorizuar, duke e bërë atë të papërshtatshëm për përmbushjen e kërkesave të kontratës.

Në mënyrë më të detajuar sqarojmë se në përputhje me kuadrin rregullator të Bashkimit Europian për produktet biocide, konkretisht me Rregulloren (BE) nr. 528/2012 (BPR) dhe praktikën e Agjencisë Europiane të Kimikateve (ECHA) mbi bazën e të cilit bazohet ligji shqiptar për biocideve, përmbledhja e karakteristikave të produktit (Summary of Product Characteristics SPC) përbën dokumentin themelor ligjor dhe teknik mbi të cilin përcaktohet në mënyrë përfundimtare spektri i përdorimit të autorizuar të një produkti biocid.

[https://echa.europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-products/-/disbp/factsheet/FR*0009287-](https://echa.europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-products/-/disbp/factsheet/FR*0009287-0000/authorisationid?Disabiocidalproducts_ËAR_disabiocidalproductsportlet_authorisationId=FR-0009287-0000)

[0000/authorisationid?Disabiocidalproducts_ËAR_disabiocidalproductsportlet_authorisationId=FR-0009287-0000](https://echa.europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-products/-/disbp/factsheet/FR*0009287-0000/authorisationid?Disabiocidalproducts_ËAR_disabiocidalproductsportlet_authorisationId=FR-0009287-0000)

Nga analiza e të dhënave konkrete të produkteve të linjës AQUABAC rezulton se SPC-të e miratuara për këto produkte, nuk përfshijnë mushkonjat e gjinisë *Anopheles* si organizma target të autorizuar, për shkak të mungesës së provave të mjaftueshme dhe të konsoliduara mbi efikasitetin e produktit ndaj kësaj gjinie në kuadër të vlerësimeve të kryera nga autoritetet kompetente europiane.

Ky element ka rëndësi vendimtare, pasi në sistemin rregullator të produkteve biocide, përfshirja e një organizmi target në SPC nuk është një çështje deklarative, por rezultat i një procesi rigoroz vlerësimi shkencor mbi bazën e të dhënave të paraqitura në dosjen e regjistrimit në BE. Në rastin kur këto të dhëna konsiderohen të pamjaftueshme, autoritetet kompetente refuzojnë përfshirjen e organizmit përkatës në spektrin e përdorimit të autorizuar. Në këto kushte, nëse SPC i një produkti specifik nuk përfshin gjininë *Anopheles*, ky produkt nuk është i autorizuar për përdorim kundër kësaj gjinie, pavarësisht faktit se substanca aktive (*Bacillus thuringiensis israelensis Bti*) mund të ketë në mënyrë teorike efikasitet biologjik ndaj saj. Autorizimi nuk bazohet në potencialin teorik të substancës aktive, por në provat konkrete të efikasitetit për produktin përfundimtar në kushtet e përdorimit për të cilat kërkohet autorizimi.

Nga kjo rrjedh një parim themelor: SPC është dokumenti ligjor referues dhe detyrues, dhe çdo informacion i pasqyruar në etiketë apo në dokumentacionin tregtar të produktit duhet të jetë një riprodhim i saktë dhe i plotë i përmbajtjes së tij. Në rast se SPC kufizon përdorimin e produktit vetëm ndaj gjinive *Aedes* dhe *Culex*, atëherë çdo pretendim për efikasitet ndaj *Anopheles* bie ndesh me këtë dokument dhe përbën shkelje të drejtpërdrejtë të rregullores BPR.

Për më tepër, përfshirja në etiketë ose në dokumentacione pretendimeve për efikasitet ndaj një organizmi target që nuk është i përfshirë në SPC përbën një shkelje të rëndë të rregullave

të etiketimit dhe të ndalimit të pretendimeve mashtruese, sipas nenit 69 të Rregullores (BE) nr. 528/2012. Ky nen ndalon në mënyrë eksplicite çdo deklaram që mund të çojë në keqinformim të përdoruesit lidhur me efikasitetin real të produktit. Në rastin konkret, përdorimi i formulimeve të përgjithshme si efektiv ndaj të gjitha llojeve të mushkonjave ose referenca të tjera të ngjashme, në kushtet kur SPC nuk përfshin gjininë *Anopheles*, përbën një mospërputhje të qartë ndërmjet dokumentacionit të miratuar dhe pretendimeve të bëra për produktin. Kjo mospërputhje nuk është vetëm formale, por prek thelbin e besueshmërisë së produktit dhe të përputhshmërisë së tij me kërkesat teknike të tenderit.

Nga ana teknike, arsyeja e këtij kufizimi lidhet me faktin se larvat e gjinisë *Anopheles* kanë karakteristika biologjike të ndryshme nga ato të gjinive *Aedes* dhe *Culex*, veçanërisht përsa i përket mënyrës së ushqyerjes dhe pozicionimit në sipërfaqen e ujit. Për këtë arsye, kërkohen studime specifike dhe shpesh nivele më të larta të efikasitetit për të provuar kontrollin e tyre. Në mungesë të këtyre provave, autoritetet rregullatore nuk lejojnë përfshirjen e kësaj gjinie në SPC si organizëm target që luftohet.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se dallimet midis produkteve të ndryshme që përmbajnë të njëjtën substancë aktive (si p.sh. krahasimi midis AQUABAC dhe produkteve të tjera si VectoBac) nuk qëndrojnë në vetë substancën aktive, por në cilësinë dhe plotësinë e dosjes teknike të paraqitur për regjistrim në ECHA e cila është referenca e ligjit shqiptarë për lëndët biocide. Në rastet kur prodhuesi ka paraqitur prova të mjaftueshme për efikasitet ndaj *Anopheles*, kjo gjini përfshihet në SPC, në të kundërt, ajo përjashtohet.

Në këto kushte, nuk ekziston asnjë bazë ligjore apo teknike për të zgjeruar në mënyrë interpretative spektrin e përdorimit të një produkti përtej asaj që është miratuar në SPC. Çdo përpjekje për ta bërë këtë, qoftë përmes formulimeve të përgjithshme në etiketë apo përmes interpretimit të gjerë të dokumentacionit, përbën shmangie të drejtpërdrejtë të rregullave të BPR dhe cenon rëndë integritetin e procesit të vlerësimit.

Për rrjedhojë, në rastin konkret, fakti që produktet e tipit AQUABAC nuk luftojnë gjininë *Anopheles* çon në përfundimin se këto produkte nuk përmbushin kërkesat teknike thelbësore të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit, të cilat kërkojnë në mënyrë eksplicite kontrollin efektiv të kësaj gjinie.

Në këto kushte, çdo vlerësim që i konsideron këto produkte si të përputhshme me specifikimet teknike është juridikisht i pabazuar dhe teknikisht i pasaktë, duke çuar në një vendimarrje të gabuar dhe në cenimin e parimeve të barazisë dhe konkurrencës në procedurën e prokurimit publik.

Në vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së prokurimit dhe të vendimarrjes së Autoritetit Kontraktor, rezulton se mënyra e trajtimit të përputhshmërisë teknike të ofertave ka çuar në një devijim thelbësor nga kërkesat e Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe nga parimet bazë të prokurimit publik, duke imponuar si pasojë të domosdoshme anulimin e procedurës.

Siç është analizuar në mënyrë të detajuar më sipër, produktet e paraqitura nga operatori ekonomik i kualifikuar nuk përmbushin një nga kërkesat teknike thelbësore të përcaktuara në DST, konkretisht efikasitetin e provuar dhe të autorizuar kundë mushkonjave të gjinisë *Anopheles*. Ky element nuk përbën një mangësi të natyrës formale apo të korigjueshme, por një mungesë substanciale që lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e ofertës për të përmbushur objektin e kontratës.

Në përputhje me kuadrin ligjorë shqiptarë të produkteve biocide dhe standardet e ECHA-s, përmbledhja e karakteristikave të produktit (SPC) përbën dokumentin ligjor referues për përcaktimin e përdorimeve të miratuar të produktit. Në rastin konkret, mungesa e përfshirjes

së gjinisë *Anopheles* në SPC, për shkak të mungesës së provave të mjaftueshme të efikasitetit, përbën një kufizim juridik të qartë që ndalon përdorimin e produktit për këtë qëllim. Në këto kushte, produkti nuk mund të konsiderohet në përputhje me kërkesat e tenderit, të cilat kërkojnë në mënyrë eksplicite kontrollin efektiv të kësaj gjinie.

Domosdoshmëria për kontrollin e gjinisë *Anopheles* është e qartë, duke qenë se në territorin e Republikës së Shqipërisë janë të pranishme disa specie të kësaj gjinie, të cilat mund të veprojnë si bartëse të *Plasmodium*-it, agjentit shkaktar të malaries. Për këtë qëllim, bashkëlidhet një hartë e Republikës së Shqipërisë, ku paraqiten speciet e identifikuar në kuadër të një studimi të realizuar nga entomologë ekspertë shqiptarë.

Gjithashtu, duhet theksuar se projekti aktual në Shqipëri për kontrollin larvicidal të mushkonjave ka lindur pikërisht si përgjigje ndaj nevojës për kontrollin e gjinisë *Anopheles*, pas shfaqjes së disa rasteve të malaries në vend gjatë viteve 2010. Dy rastet e para të konfirmuara u identifikuan tek dy punëtorë nga zona Sarandë Përmet, të cilët ishin kthyer nga Greqia. Më pas, në vitet 2012-2013, u konfirmuan edhe pesë raste të tjera, që përfshinin persona të kthyer nga Guinea Ekuatoriale, ku kishin kontraktuar infeksionin, i cili u diagnostikua pas kthimit të tyre në Vlorë.

Një faktor tjetër kyç që duhet të vlerësohet në mënyrë objektive dhe të reflektohet në specifikimet teknike është efekti i zgjatur i produktit, i cili ka rëndësi thelbësore për planifikimin e trajtimeve. Ky efekt ndikohet nga karakteristikat e ujit ku aplikohet (Bti). Studimet mbi qëndrueshmërinë e produktit në prani të lëndës organike të tretur në ujë kanë treguar se këta faktorë mund të ndikojnë ndjeshëm në kohëzgjatjen e efikasitetit të trajtimeve larvicidale të bazuara në Bti ose në kombinimin Bti + Bs.

Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, është faktori i efikasitetit në raport me dozën për hektar (dozë/ha), i cili merr një rëndësi themelore. Përdorimi i dozave më të ulëta, duke ruajtur të njëjtin ose një nivel më të lartë efikasiteti, kontribuon si në reduktimin e ndikimit në mjedis, ashtu edhe në optimizimin e kostove për operatorin, me kusht që të respektohen në mënyrë profesionale dozat minimale të përcaktuara nga formulimi i biocidit.

Theksojmë se, në rast të një epidemie të malaries, përgjegjësia institucionale bie drejtpërdrejt mbi autoritetin kontraktor/kompetent që autorizon përdorimin e produkteve të tilla si Aquabac, nëse këto nuk garantojnë një kontroll efektiv të gjinisë *Anopheles*. Për rrjedhojë, është thelbësore që në specifikimet teknike dhe në procesin e vlerësimit të përfshihen kërkesa të qarta dhe të verifikueshme mbi efikasitetin e produktit ndaj kësaj gjinie, me qëllim minimizimin e çdo rreziku për shëndetin publik.

Pavarësisht kësaj mospërputhjeje të qartë dhe të provuar, Autoriteti Kontraktor ka proceduar me kualifikimin e ofertës në fjalë, duke u mbështetur në mënyrë të gabuar në ekzistencën e një autorizimi formal të produktit dhe duke mos kryer një analizë të plotë të përmbajtjes teknike të tij.

Një qasje e tillë përbën një devijim të rëndë nga standardet e vlerësimit të ofertave, pasi autorizimi formal nuk mund të zëvendësojë verifikimin e përputhshmërisë reale me specifikimet teknike të tenderit.

Në të njëjtën kohë, Autoriteti Kontraktor ka aplikuar një standard të ndryshëm dhe dukshëm më të rreptë ndaj operatorit ekonomik NRG sh.p.k., duke e skualifikuar për mungesë të një elementi formal, ndërkohë që ka toleruar një mospërputhje thelbësore në përmbajtjen teknike të ofertës së operatorit tjetër. Ky trajtim i diferencuar përbën shkelje të drejtpërdrejta të parimit të barazisë dhe të trajtimit të njëjtë të operatorëve ekonomikë, si dhe cenon rëndë parimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Për më tepër, ky devijim në vlerësimin teknik nuk ka karakter të izoluar, por ka prodhuar një efekt të drejtpërdrejtë dhe vendimtar në rezultatin e procedurës së prokurimit. Në kushtet kur operatori ekonomik që nuk përmbush specifikimet teknike është kualifikuar, ndërsa operatori tjetër është skualifikuar mbi baza formale, rezultati i procedurës është deformuar në mënyrë thelbësore, duke eliminuar konkurrencën reale dhe duke çuar në përzgjedhjen e një oferte që nuk garanton përmbushjen e objektit të kontratës.

Në këtë kontekst, procedura e zhvilluar nuk mund të konsiderohet më si një procedurë e rregullt prokurimi në kuptimin e ligjit nr. 162/2020, pasi ajo nuk garanton përzgjedhjen e ofertës më të përshtatshme në bazë të kriterëve të përcaktuara dhe nuk siguron përdorimin efikas të fondeve publike. Përkundrazi, ajo rezulton e ndikuar nga një vlerësim i njëanshëm dhe i paplotë i ofertave, që cenon interesin publik dhe besimin në integritetin e procesit.

Në këto kushte, duke qenë se shkeljet e konstatuara janë të natyrës substanciale, prekin elemente thelbësore të procedurës dhe kanë ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin e saj, ato nuk mund të korrigjohen përmes rivlerësimit të ofertave, por imponojnë si zgjidhje të vetme ligjore anulimin e procedurës së prokurimit dhe rishpalljen e saj në përputhje me ligjin dhe specifikimet teknike të përcaktuara.

II. Vec sa më sipër, në vlerësimin e përputhshmërisë së ofertës së operatorit ekonomik Egian Med sh.p.k. me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit, një element thelbësor që rezulton të jetë keqinterpretuar si nga vetë operatori, ashtu edhe nga Autoriteti Kontraktor, lidhet me përdorimin dhe kuptimin e konceptit të ashtuquajtur *technical equivalence* (ekuivalencë teknike).

Çfarë nënkupton realisht *Technical Equivalence* sipas ECHA

Produkti Aquabac DF 3000 i përdorur nga subjekti Egian Med është një larvicid biologjik që përmban si substancë aktive *Bacillus thuringiensis subsp. israelensis* (Bti), serotipi H14, shtami BMP-144, me një përqendrim rreth 43% (=3000 ITU/mg) në formulim granular të dispergueshëm në ujë (ËG). Ky mikroorganizëm vepron përmes gëlltitjes nga larvat e dipterëve, duke prodhuar toksina kristalore që dëmtojnë epitelin intestinal të larvave dhe shkaktajnë vdekjen e tyre brenda një intervali të shkurtër kohe.

Në vlerësimin e përputhshmërisë së një produkti biocid me kërkesat e një procedure prokurimi publik, është e domosdoshme që të analizohen në mënyrë kumulative tre elemente kryesore:

1. përputhshmëria juridike e substancës aktive;
2. ekuivalenca teknike dhe dokumentacioni i autorizimit;
3. efikasiteti biologjik i provuar kundër specieveve target të kërkuara;

Në kuadër të Rregullorja (BE) nr. 528/2012 për produktet biocide, vlerësimi i *Technical Equivalence* (TE) kryhet ekskluzivisht për të verifikuar karakteristikat e substancës aktive dhe jo performancën e produktit final.

Sipas metodologjisë së European Chemicals Agency (ECHA), ekuivalenca teknike synon të konfirmojë që një substancë aktive:

- ? ka identitet të njëjtë kimik ose biologjik;
- ? ka përbërje të krahasueshme;
- ? nuk paraqet rrezik më të lartë toksikologjik apo ekotoksikologjik;
- ? prodhohet me një proces të krahasueshëm;

Pra në këtë kuptim ekuivalenca teknike përfaqëson vetëm një krahasim të substancës aktive dhe profilit të saj të rrezikut, dhe jo një vlerësim të performancës biologjike të produktit në terren.

Fakti që një produkt konsiderohet teknikisht ekuivalent me produkte të tjera me bazë Bti H14 nënkupton vetëm se përdor të njëjtën substancë aktive dhe paraqet profil analitik të krahasueshëm por përsëri kjo nuk do të thotë në mënyrë automatike se kanë efikasitet biologjik identik, specter të njëjtë të organizmave target dhe kohëzgjatje të njëjtë të efektit të habitatit.

Siç përcaktohet edhe në praktikën teknike: Ekuivalenca teknike sipas rregullores për biocidet i referohet përbërjes së substancës aktive dhe profilit të rrezikut dhe nuk nënkupton automatikisht ekuivalencë në efikasitetin biologjik, performancën në terren apo efektivitetin operacional të produktit të formuluar.

Referuar të dhënave zyrtare të publikuara në ECHA dhe dokumentacionit SPC për produktin AQUABAC DF3000, rezulton se:

? nuk paraqitet një studim për efikasitetin ndaj larvave të gjinisë Anopheles;

? dokumentacioni teknik konstaton në mënyrë eksplicite se:

“Efektiviteti ndaj Anopheles spp. nuk është i provuar dhe pretendime se substancat bioacide të Aquabac për këtë specie nuk janë të vlefshme.”

Gjithashtu, nga shqyrtimi i SPC për produktet:

? Aquabac 300DF

? Aquabac 200

? Aquabac XT

rezulton se:

? organizmat target përshkruhen në mënyrë të përgjithshme ose kufizohen në gjini të caktuara si Aedes dhe Culex;

? gjinia Anopheles spp. nuk është e përfshirë në mënyrë eksplicite si target i autorizuar;

Nga dokumentacioni i paraqitur në ofertë dhe nga argumentimi i përdorur për të mbështetur përputhshmërinë e produkteve të tipit AQUABAC me kërkesat e tenderit, rezulton se operatori ekonomik është mbështetur në faktin që substanca aktive Bacillus thuringiensis israelensis (Bti), konkretisht shtam-i i përdorur në produkt, konsiderohet teknikisht ekuivalent me një substancë tjetër të autorizuar në nivel evropian. Mbi këtë bazë, është pretenduar se produkti përmbush kërkesat teknike të tenderit.

Megjithatë, ky arsytim është juridikisht dhe teknikisht i gabuar dhe përbën një keqinterpretim të rëndë të konceptit të ekuivalencës teknike, siç ai përcaktohet në kuadrin rregullator evropian për produktet biocide dhe në praktikën e Agjencisë Europiane të Kimikateve (ECHA).

Sipas standardeve të ECHA dhe kuadrit të rregullores për produktet biocide (BPR), ekuivalenca teknike është një koncept që lidhet ekskluzivisht me krahasimin e substancave aktive nga pikëpamja kimike dhe toksikologjike, duke përfshirë elementë si identiteti i substancës, profili i papastërtive dhe karakteristikat e përgjithshme të saj. Qëllimi i këtij vlerësimi është të përcaktojë nëse një substancë aktive e prodhuar nga një burim i caktuar është teknikisht e krahasueshme me një substancë të referencës që është tashmë e miratuar.

Në asnjë rast, ekuivalenca teknike nuk përfshin dhe nuk garanton efikasitetin biologjik të produktit final, performancën e tij në kushte reale përdorimi, spektrin e organizmave target ndaj të cilëve produkti është efektiv dhe përputhshmërinë me kërkesat specifike funksionale të një procedure konkrete prokurimi. Në këtë kuptim, ekziston një dallim thelbësor midis

ekuivalencës së substancës aktive dhe përputhshmërisë së produktit final me një specifikim teknik konkret. Ky dallim është vendimtar në rastin konkret, pasi kërkesa e Dokumenteve Standarde të Tenderit nuk lidhet me identitetin apo ekuivalencën e substancës aktive në abstrakt, por me aftësinë konkrete të produktit për të realizuar kontrollin efektiv të një spektri të përcaktuar organizmash, përfshirë në mënyrë të detyrueshme gjininë *Anopheles*.

Nga analiza e dokumentacionit teknik të produkteve AQUABAC rezulton se, pavarësisht përdorimit të një substance aktive që mund të konsiderohet teknikisht ekuivalente në kuptimin e ECHA, produkti në formën e tij konkrete nuk ka të dhëna të mjaftueshme që provojnë efikasitetin ndaj *Anopheles*, nuk e përfshin këtë gjini në përshkrimin e përdorimeve të autorizuara (SPC), si dhe nuk ka demonstrim të performancës në kushtet specifike të kërkuara nga tenderi. Kjo do të thotë se, edhe nëse pranohet ekzistenca e ekuivalencës teknike në nivel të substancës aktive, kjo nuk përkethehet në mënyrë automatike në përputhshmëri të produktit me specifikimet teknike të tenderit.

Në fakt, përdorimi i konceptit të ekuivalencës teknike në këtë kontekst përbën një zgjerim të pajustificuar të kuptimit të tij dhe një përpjekje për të zëvendësuar mungesën e provave konkrete të efikasitetit me një referencë të përgjithshme mbi substancën aktive. Një qasje e tillë bie ndesh me logjikën e rregullimit të produkteve biocide, e cila kërkon që efikasiteti të demonstrohet për produktin konkret dhe për përdorimet specifike për të cilat ai synohet të përdoret. Për më tepër, pranimi i një arsytimi të tillë nga Autoriteti Kontraktor krijon një precedent të rrezikshëm, pasi do të nënkuptonte se çdo produkt që përmban një substancë aktive të konsideruar teknikisht ekuivalente mund të konsiderohet automatikisht i përshtatshëm për çdo përdorim, pavarësisht mungesës së provave konkrete të efikasitetit për atë përdorim. Kjo bie ndesh jo vetëm me standardet teknike të fushës, por edhe me vetë qëllimin e specifikimeve teknike në prokurimin publik, të cilat synojnë të garantojnë performancën reale të shërbimit që do të kontraktohet. Në rastin konkret, kjo qasje ka çuar në një vlerësim të gabuar të ofertës së operatorit ekonomik Egian Med sh.p.k., duke e konsideruar atë të përputhshme me specifikimet teknike, ndërkohë që në realitet produkti i ofruar nuk përmbush një nga kërkesat thelbësore të tenderit, konkretisht efikasitetin ndaj gjinisë *Anopheles*. Për rrjedhojë, mbështetja në konceptin e ekuivalencës teknike për të justifikuar këtë përputhshmëri është juridikisht e pabazuar dhe teknikisht e papranueshme, dhe nuk mund të përdoret si argument për të legjitimuar kualifikimin e një oferte që nuk përmbush kërkesat thelbësore të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Produkte të tjera në treg, si Vectobac, disponojnë dokumentacion teknik të konsoliduar dhe përfshijnë një spektër më të gjerë të organizmave target, duke përfshirë edhe gjininë *Anopheles* spp. Megjithatë, ky fakt nuk mund të transferohet automatikisht tek produkti AQUABAC DF3000, për shkak se nuk ekziston një ekuivalencë biologjike e provuar dhe e reflektuar në dokumentacionin zyrtar të tij (SPC). Për rrjedhojë, referimi i përgjithshëm ndaj larvave të mushkonjave nuk përbën provë të mjaftueshme për të konfirmuar efektivitetin ndaj të gjitha specieve të kërkuara nga specifikimet teknike të tenderit.

Nga analiza e dokumentacionit teknik të disponueshëm rezulton se produkti AQUABAC DF3000 e etj, nuk demonstron në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar efikasitet kundër të gjitha specieve target të kërkuara, në veçanti për gjininë *Anopheles*. Referuar të dhënave të Agjencisë Amerikane të Mbrojtjes së Mjedisit (EPA), SHBA, theksohet se kjo agjenci nuk i konsideron ekuivalente shtamet e *Bacillus thuringiensis israelensis* (Bti), konkretisht BMP144 dhe AM65-52. Ky fakt dëshmon qartë se mungesa e specifikimit të saktë të shtameve në etiketimin e produkteve mikrobiale/larvicide përbën një mangësi serioze, e cila mund të

ndikojë drejtpërdrejt në efikasitetin e produktit dhe në përmbushjen e objektivave të kontrollit.

Në mbështetje të pretendimeve të mësipërme paraqitet si provë dokumentare korrespondenca elektronike zyrtare e datës 13.04.2026 e ardhur nga ANSES Agjencia Franceze për Sigurinë Ushqimore, Mjedisore dhe të Shëndetit në Punë , konkretisht nga njësia kompetente Biocides Coordination Unit , autoritet teknik përgjegjës për administrimin dhe koordinimin e autorizimit të produkteve biocide në Republikën Franceze. Nga kjo korrespondencë rezulton se vetë autoriteti teknik francez konfirmon shprehimisht se produktet AQUABAC 200G, AQUABAC DF3000 dhe AQUABAC XT janë të autorizuar në Francë vetëm për përdorim kundër mushkonjave të gjinive Aedes spp. dhe Culex spp., dhe jo për përdorim kundër mushkonjave të gjinisë Anopheles spp.

Ky informacion ka rëndësi të drejtpërdrejtë për çështjen, pasi demonstroi se në shtetin referues nga i cili pretendohet të jetë marrë baza dokumentare për autorizimin e këtyre produkteve, vetë autoriteti teknik kompetent njeh se këto produkte nuk disponojnë autorizim dhe përdorim të miratuar për kontrollin e mushkonjave të gjinisë Anopheles. Në këto kushte, nëse autoriteti shqiptar ka lëshuar autorizim për këto produkte duke i konsideruar të përshtatshme për përdorime që përfshijnë edhe këtë gjini, rezulton prima facie se autorizimi është nxjerrë në kundërshtim me dokumentacionin teknik referues dhe përtej kufijve të të dhënave mbi bazën e të cilave produkti është autorizuar në juridiksionin e origjinës/referencës.

Ky fakt përforcon ndjeshëm dyshimin se organi administrativ shqiptar ka interpretuar ose përdorur në mënyrë të gabuar konceptin e ekuivalencës teknike dhe/ose dokumentacionin teknik referues, duke njohur efekte biologjike që nuk rezultojnë të autorizuar dhe të provuara nga vetë autoriteti teknik i shtetit referues. Një autorizim i lëshuar në këto kushte ngre dyshime serioze mbi përputhshmërinë e tij me kriteret materiale të VKM nr. 933/2020 dhe mbi respektimin e standardit të hetimit të plotë dhe objektiv administrativ.

Edhe pse vetë ANSES sqaron se përgjigjja e Helpdesk nuk përbën opinion juridik detyrues, kjo nuk ia zbeh vlerën tekniko-shkencore, pasi informacioni i dhënë përfaqëson deklaram zyrtar të autoritetit teknik kompetent mbi kufijtë e autorizimit të këtyre produkteve në Francë dhe mbi të dhënat e regjistruara në bazën zyrtare të ECHA për produktet biocide të autorizuar në Bashkimin Evropian.

Në përfundim, produkti AQUABAC DF3000 nuk mund të konsiderohet i përshtatshëm për objektin e këtij prokurimi, pasi autorizimi formal nuk zëvendëson verifikimin teknik të efikasitetit biologjik dhe të përputhshmërisë së plotë me kërkesat e specifikimeve teknike të tenderit.

III. Në analizën e përputhshmërisë së ofertës së operatorit ekonomik Egian Med sh.p.k. me kërkesat e Dokumenteve Standarde të Tenderit, një element me rëndësi vendimtare lidhet me mospërputhjen midis dokumentacionit të paraqitur nga ky operator dhe dokumentacionit zyrtar të miratuar nga autoritetet ndërkombëtare rregullatore, si dhe me keqinterpretimin e rolit të autorizimit formal në raport me përmbajtjen reale teknike të produktit.

Nga verifikimet e kryera mbi dokumentacionin teknik të produkteve të ofruara rezulton se etiketat dhe të dhënat përkatëse të paraqitura në ofertë nuk përputhen me etiketat dhe specifikimet e miratuara nga autoritetet kompetente ndërkombëtare, konkretisht nga Environmental Protection Agency (EPA) dhe databazat përkatëse referuese. Kjo mospërputhje nuk përbën një devijim formal apo një pasaktësi të vogël dokumentare, por prek thelbin e besueshmërisë së produktit dhe të informacionit mbi të cilin mbështetet

vlerësimi i ofertës. Etiketa e një produkti biocid përbën një element thelbësor të identitetit të tij teknik dhe ligjor, pasi në të përcaktohen në mënyrë të detajuar përbërja e produktit, organizmat target për të cilët është i autorizuar përdorimi, kushtet dhe kufizimet e përdorimit, si dhe pretendimet e lejuara për efikasitet.

Në këtë kuptim, çdo mospërputhje ndërmjet etiketës së paraqitur dhe asaj të miratuar nga autoriteti kompetent krijon pasiguri mbi vetë identitetin e produktit dhe mbi saktësinë e pretendimeve të bëra për efikasitetin e tij. Për më tepër, në kuadrin e rregullimit të produkteve biocide, etiketa e miratuar dhe dokumenti i përshkrimit të produktit (SPC) kanë karakter detyrues dhe përbëjnë burimin e vetëm të autorizuar për vlerësimin e përdorimit të produktit. Çdo devijim nga këto dokumente nuk mund të merret në konsideratë si bazë e vlefshme për vlerësim teknik. Në rastin konkret, fakti që produktet e paraqitura nuk reflektojnë në mënyrë të saktë të dhënat e miratuara ndërkombëtarisht dhe përmbajnë pretendime që nuk janë të konfirmuara në dokumentacionin zyrtar, cenon drejtpërdrejt besueshmërinë e ofertës dhe duhet të çonte në skualifikimin e saj. Autoriteti Kontraktor, në vend që të verifikonte përputhshmërinë e këtyre të dhënave me burimet zyrtare, ka pranuar në mënyrë të pakritikueshme dokumentacionin e paraqitur, duke dështuar në ushtrimin e detyrimit për një vlerësim objektiv dhe të plotë të ofertave.

Ky problem lidhet ngushtë edhe me një çështje tjetër thelbësore, që ka të bëjë me raportin midis ekzistencës së një autorizimi formal dhe përputhshmërisë reale teknike të produktit me kërkesat e tenderit.

Në praktikën e ndjekur nga Autoriteti Kontraktor, rezulton se ekzistenca e një autorizimi formal për produktin është trajtuar si element i mjaftueshëm për të konkluduar mbi përputhshmërinë e tij me specifikimet teknike. Një qasje e tillë është juridikisht dhe teknikisht e gabuar.

Autorizimi i një produkti biocid është një akt administrativ që lidhet me lejimin e vendosjes së produktit në treg dhe me vlerësimin e tij në raport me kriteret e përgjithshme të sigurisë dhe përdorimit. Ky autorizim bazohet në dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi dhe në një vlerësim që ka karakter të përgjithshëm dhe nuk është i orientuar drejt kërkesave specifike të një procedure konkrete prokurimi. Në të kundërt, specifikimet teknike të tenderit janë të ndërtuara mbi nevoja konkrete funksionale dhe kërkojnë që produkti të përmbushë standarde të caktuara performancë për një përdorim të caktuar, në këtë rast kontrollin efektiv të një spektri të përcaktuar organizmash, përfshirë në mënyrë të detyrueshme gjininë *Anopheles*.

Për rrjedhojë, ekzistenca e një autorizimi formal nuk mund të konsiderohet në vetvete si provë e përputhshmërisë me këto kërkesa. Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të verifikojë në mënyrë të pavarur nëse produkti ka efikasitet të provuar për organizmat target të kërkuar, nëse ky efikasitet është i reflektuar në dokumentacionin zyrtar të produktit dhe nëse përdorimi i produktit për këtë qëllim është i autorizuar.

Në rastin konkret, edhe nëse pranohet ekzistenca e një autorizimi formal për produktet AQUABAC, ky autorizim nuk përfshin dhe nuk mbështet përdorimin e produktit për kontrollin e gjinisë *Anopheles*, për shkak të mungesës së provave të mjaftueshme shkencore. Në këto kushte, produkti nuk përmbush kërkesat teknike të tenderit, pavarësisht ekzistencës së autorizimit. Pranimi i një oferte në këto kushte përbën një devijim serioz nga standardet e vlerësimit të ofertave dhe krijon një precedent të rrezikshëm, pasi do të nënkuptonte se çdo produkt i autorizuar mund të konsiderohet automatikisht i përshtatshëm për çdo përdorim, pavarësisht kufizimeve të tij reale teknike.

Në përfundim, kombinimi i mospërputhjeve në dokumentacion dhe etiketim, së bashku me mbështetjen e gabuar në ekzistencën e një autorizimi formal si zëvendësim për verifikimin e përmbajtjes teknike, tregon qartë se Autoriteti Kontraktor nuk ka kryer një vlerësim të plotë, objektiv dhe në përputhje me ligjin të ofertës së operatorit ekonomik Egian Med sh.p.k., duke çuar në një vendimmarrje të gabuar dhe në cenimin e parimeve themelore të prokurimit publik.

IV. Rasti kur kjo shoqëri është kualifikuar duke përdorur produkte me veprim mekanik është një element tjetër i cili bie ndesh me rregullat dhe ligjet e prokurimit publik. Duke iu referuar specifikimeve teknike në DST për produktet që do të përdoren në lidhje me llojet e ndryshme të habitateve dhe zonave që do të kontrollohen, kërkohet qartësisht vetëm produkte të bazuara në *Bacillus thuringensis israeliensis* ose *Bacillus thuringensis israeliensis* i kombinuar me *Lysinibacillus Sphaericus* specifikisht në Zonat e Mbrojtura të tilla si zonat e bregdetit shqiptar dhe parqet natyrore të mbrojtura (ZMN), të pasura me biodiversitet (ligji nr. 81/2017). Ky koncept del dukshëm në pah nga raporti TAIEX ID: 82903 i hartuar më 09/12/2022 pas misionit të kryer në Shqipëri nga data 21 deri më 25 nëntor 2022.

Në raport është cituar disa herë se në zonat e mbrojtura të NPA (zonat e mbrojtura natyrore) si të parqet natyrore, të cilat janë të mbrojtura me ligjin 81/2017 për shkak të biodiversitetit të madh të pranishëm, duhet të përdoren vetëm produkte biologjike me bazë *Bacillus bacillus thuringensis israeliensis* ose *Lysinibacillus sphaericus*. Ky koncept është theksuar sidomos nga Dr. Ruben Bueno në dokumentin e dërguar nga MSH nëpërmjet ISHP-së më 15.12.2022 (nr. protokolli 1433), në bashkërendim me ASPP (nr. protokolli 1827/1) dhe kopje të të cilit e gjeni bashkangjitur, ku mund të lexohet qartë, në pjesën me emertimin Kontrolli i Mushkonjave dhe përgjigja ndaj shpërthimeve që tregon se edhe në Spanjë produkte biologjike me bazë *Bacillus bacillus thuringensis israeliensis* ose *Lysinibacillus sphaericus* janë të vetmit përbërës aktivë që përdoren në Zonat Natyrore të Mbrojtura për konservimin e biodiversitetit.

I njëjti koncept shfaqet edhe në rekomandimet (pika 3 germa d) ku thuhet: Për më tepër, për të ruajtur qetësinë e avifaunës, duhet të zbatohet trajtimi biocid me dron. Rekomandohet që në këto zona trajtimet me larvicide duhet të bazohen në produkte larvicide biologjike si *Bacillus thuringensis israeliensis* dhe/ose i kombinuar me *Lysinibacillus sphaericus*. Kur flasim për MMF, gjëja e parë e dukshme është se nuk është një produkt biocid, por një produkt me veprim mekanik (barrierë fizike) që kontrollon larvat e mushkonjave, për të cilin disa vende ende kërkojnë regjistrim kombëtar (Emiratet e Bashkuara Arabe, Brazili etj). Megjithatë, ky produkt nuk figuron në listën e MSHMS të lëndëve aktive me aktivitet biocid të autorizuar për import në Republikën e Shqipërisë, kusht ky për regjistrimin e lëndëve biocid të shoqëruara me gjithë dosjen voluminoze të regjistrimit që garanton sigurinë dhe aktivitetin veprues të produktit.

Për më shumë nuk egziston ndonjë vendim i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për ta përjashtuar këtë produkt nga procesi i regjistrimit.

Theksojmë se për çdo produkt biocid që regjistrohet në ECHA (Agjencia Evropiane e Produkteve Kimike), çdo prodhuesi, i kërkohet të mbrojë lëndën aktive, për të cilën i është dashur të investojë vite kohë dhe studime për të vërtetuar se plotëson normat dhe standartet të tilla si: kancerogjeneza, teratogjeneza, ndikimi mjedisor, destinacioni mjedisor, toksiciteti në ekosistemet në të cilat do të përdoret, toksiciteti për njerëzit, toksiciteti kronik për operatorin, dozat, vlerësimi i rrezikut, efikasiteti në organizmin e synuar, lloji i përdorimit, lloji i operatorëve që mund ta përdorin. Kjo do të thotë të garantosh siguri se ajo që do të

përdoret plotëson të gjitha kërkesat bazë për të nxjerrë një produkt të sigurt në mjedis. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, rëndësia që këto produkte duhet të përdoren nga operatorë profesionistë të trajnuar. Duke folur për përdorimin MMF filmat monomolekularë, është e qartë se studimet në dispozicion nuk janë të plota dhe të mjaftueshme.

Kemi të bëjmë me një produkti, me bazë silikonit që përdoret gjerësisht në kozmetikë, dhe kjo na shtyn të konsiderojmë mbi të gjitha ndikimin në mjedis, veçanërisht në Zona Natyrore të Mbrojtura ku specifikohen jo pa arsye larvicidat biollogjike që duhet të përdoren. Mjafton të kujtojmë fushatën e madhe që sot është në mbarë botën për mikroplastikën, dhe midis produkteve që shkaktojnë ndotje janë ato me bazë silikonit të tilla si MMF. Një element tjetër për tu konsideruar është funksionimi i këtij produkti, prodhuesi deklaroi se produkti Aquatain, shpërndahet mbi ujë si një film silikonit, i cili përshkon sipërfaqen e ujit dhe vret larvat e mushkonjave duke i penguar ato të marrin frymë, në të njëjtën kohë edhe të rriturat. Mushkonjat që mbështeten në të për të bërë vezë, thyejnë shtresën e filmit të silikonit dhe mbyten.

Duke parë me kujdes të dhënat e publikuara, gjëja e parë që del në pah është ndikimi në disa insekte që jetojnë në sipërfaqen e ujit dhe që nuk janë objektiv i luftës larvicide, si Notonectidae, një grup insektesh (grupi Heteroptera) që gjendet në të gjithë botën dhe e ka marrë emrin nga aftësia e tyre për të notuar me kurriz, të cilat janë në formë ovale si anët e një varke. Notonectidae, përdor këmbët e tij të gjata si rrema për shtyrë dhe ka një kokë në formë ovale dhe trup të zgjatur, zakonisht më pak se 15 mm (0.6 in) të gjatë. Këto insekte preken nga filmi monomolekularë vriten.

Këto insekte gjenden në të gjitha lagunat tona dhe në zonat natyrore të mbrojtura (ZNM-të). Këtu vlen të theksohet se programi ka për qëllim vetëm luftimin e larvave të mushkonjave dhe jo insektet të tjera ujore të cilat gjenden.

Të mos harrojmë se në Zonat Natyrore të Mbrojtura shpesh ka pjesë me bimësi shumë të bollshme dhe kallamishte, shumë të vështira për t'u depërtuar nga produkte me përmbajtje emulsioni dhe prandaj trajtohen me produkte në formë granule nga toka ose nga ajri. Në këto zona aplikimi i Aquatain si barrierë fizike nga toka është i padobishëm sepse produkti i lëngshëm nuk mund të aplikohet me spërkatje me dron, teknikisht për dy arsye:

1) produkti është silikon dhe për densitetin që ka duhen përdorur pompa shumë të fuqishme për ta aplikuar, gjë që nuk mund të realizohet me dron.

2) aplikimi i MMF në zonat me bimësi të zhvilluar do të lejonte vetëm lagjen e pjesës së sipërme të bimësisë pa depërtuar në zonat me ujë, ku ndodh riprodhim larvor që janë target i aplikimit.

Në këtë pikë mund të konsiderohet përdorimi i produktit Aquatain drops, kapsula të shpërndara me dron. Për trajtimin e një metër katror, doza minimale është 4 kapsula (gjithsej 1 mm).

*Ndërsa kur flasim për shpërndarjen e këtyre formulimeve me bazë MMF në zonat urbane theksojmë se nga eksperiencia e NRG shpk në vitet e kaluar gjatë përdorimit të MMF është evidentuar se në pusetat e ujrave të bardha të qytetit mund të aplikohet vetëm pas reshjeve, kjo sepse në mungesë të ujrave produkti do të përthithet nga mbetjet ranore dhe nuk do të ketë efekt afatgjatë. Si pasojë nuk do të ketë aktivitet vepruar në mënyrë parandaluese, gjë që mundësohet kur bëhet trajtimi me granula të cilat treten në ujë duke vepruar menjëherë dhe mbi të gjitha kombinimi i Bti (*Bacillus thuringiensis israelensis*) dhe Bs (*Bacillus sphaericus*) do të lejojë një qëndrueshmëri në brendësi të pusetës për të paktën 45 ditë edhe kur është e thatë pasi ngelet i ngjitur në parete, dhe direkt mbas rreshjeve fillon të aktivizohet përsëri.*

Konsideruar sa më sipër arrijmë në konkluzionin që profesionaliteti dhe njohuritë e fushës dhe ato juridike të antarëve të KVO lënë shumë për të dëshiruar, apo në të kundërt kanë mbyllur sytë qëllimisht.

V. Në vijim të analizës së zhvilluar mbi përputhshmërinë teknike të ofertave dhe mbi vendimmarrjen konkrete të Autoritetit Kontraktor, rezulton se procedura e prokurimit në fjalë është zhvilluar në kundërshtim të hapur me parimet themelore që rregullojnë prokurimin publik, duke prodhuar një rezultat të deformuar dhe juridikisht të papranueshëm.

Së pari, është cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë parimi i barazisë në trajtim të operatorëve ekonomikë. Ky parim kërkon që të gjithë pjesëmarrësit në procedurë të vlerësohen mbi bazën e të njëjtave kritere, të interpretuara dhe të zbatuara në mënyrë të njëtrajtshme dhe të paanshme.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimit të produktit biocid si kusht kualifikimi është interpretuar në mënyrë formale dhe disproporcionale, në kundërshtim me parimet e ligjit nr. 162/2020 Për prokurimin publik, konkretisht parimin e proporcionalitetit, parimin e konkurrencës së lirë dhe efektive dhe parimin e trajtimit të barabartë. Autorizimi i produktit biocid nuk përbën kriter të kapacitetit teknik të operatorit ekonomik, por një element që lidhet me produktin dhe përdorimin e tij gjatë ekzekutimit të kontratës. Në këtë kuptim, interpretimi i Autoritetit Kontraktor për ta trajtuar këtë element si kusht skualifikues absolut është i gabuar dhe në kundërshtim me natyrën juridike të këtij dokumenti.

Skualifikimi i shoqërisë sonë është rezultat i një situate të krijuar artificialisht nga vetë organet shtetërore, konkretisht nga vonesat dhe trajtimi arbitrar i aplikimeve për autorizim nga Ministria e Shëndetësisë. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se shoqëria jonë ka aplikuar për autorizim në përputhje me VKM nr. 933/2020, brenda afatit ligjor nuk është njoftuar për mangësi në dosje, ndaj për rrjedhojë, aplikimi duhet të konsiderohej i pranuar sipas mekanizmit të heshtjes administrative. Në këto kushte, penalizimi i operatorit ekonomik për shkak të mosveprimit të administratës përbën shkelje të rëndë të parimit të sigurisë juridike dhe të besimit të ligjshëm.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktor ka aplikuar një standard të dyfishtë vlerësimi, nga njëra anë, ka skualifikuar shoqërinë NRG sh.p.k. për mungesë të një elementi formal, konkretisht autorizimin e produktit biocid në momentin e hapjes së ofertave, ndërkohë që nga ana tjetër ka kualifikuar operatorin ekonomik Egian Med sh.p.k., pavarësisht faktit se produkti i paraqitur prej tij nuk përmbush një kërkesë thelbësore teknike të përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht efikasitetin e provuar dhe të autorizuar ndaj mushkonjave të gjinisë Anopheles. Ky trajtim i diferencuar nuk mund të justifikohet me asnjë argument juridik apo teknik, pasi krijon një situatë ku kërkesat formale zbatohen në mënyrë rigorozë dhe absolute ndaj një operatori, ndërkohë që mangësitë substanciale tolerohen ndaj një operatori tjetër. Një qasje e tillë përbën jo vetëm shkelje të parimit të barazisë, por edhe një devijim të rëndë nga standardi i paanësisë që duhet të karakterizojë veprimtarinë e Autoritetit Kontraktor.

Së dyti, është cenuar parimi i konkurrencës efektive dhe të ndershme. Qëllimi themelor i procedurave të prokurimit publik është garantimi i një gare reale ndërmjet operatorëve ekonomikë, në mënyrë që të përzgjidhet oferta që përmbush në mënyrë optimale kërkesat teknike dhe ekonomike të autoritetit. Në rastin konkret, përjashtimi i një operatori që, në kushte normale, do të kishte qenë në gjendje të konkurrojë, për shkak të një elementi formal të ndikuar nga mosveprimet e administratës, i kombinuar me kualifikimin e një operatori që nuk përmbush kërkesat teknike, ka eliminuar konkurrencën reale në procedurë. Kjo situatë ka

prodhuar një efekt të qartë përjashtues, ku gara nuk është zhvilluar mbi bazën e meritës dhe përputhshmërisë teknike, por është deformuar nga një vlerësim selektiv dhe i njëanshëm i ofertave. Në këto kushte, rezultati i procedurës nuk reflekton një konkurrencë të ndershme, por një për zgjedhje të kushtëzuar nga faktorë të jashtëm ndaj kritereve objektive të tenderit.

Një element që ngre dyshime serioze mbi mënyrën e funksionimit të konkurrencës në këtë procedurë lidhet me faktin se shoqëria Egian Med, si mbajtëse e autorizimit për linjën e produkteve Aquabac, nuk ka marrë pjesë në procedurë në mënyrë të plotë, por vetëm në Lotet nr. II, III dhe IV, ndërkohë që nga pikëpamja e kapaciteteve dhe kritereve kualifikuese rezulton se ajo kishte mundësi objektive për të marrë pjesë edhe në lote të tjera. Në të njëjtën kohë, në Lotin nr. 5, ku Air sh.p.k. është shpallur operator i kualifikuar, nuk rezulton pjesëmarrja e shoqërisë Egian Med, pavarësisht se kjo e fundit është subjekti që disponon autorizimin për produktin e përdorur nga operatori i kualifikuar. Kjo sjellje krijon një konfigurim faktik ku një subjekt mban autorizimin formal të produktit, ndërsa një subjekt tjetër paraqitet në procedurë si ofertues i vetëm i kualifikuar, duke përdorur të njëjtin produkt.

Ky konfigurim, i analizuar në tërësi me rrethanat e tjera të procedurës, përfshirë mungesën e konkurrencës reale dhe kualifikimin e vetëm të një operatori, krijon dyshime të arsyeshme mbi ekzistencën e një koordinimi ndërmjet subjekteve pjesëmarrëse, që potencialisht mund të cenojë konkurrencën e lirë dhe të ndershme në kuptim të legjislacionit për prokurimin publik dhe të drejtës së konkurrencës. Në veçanti, ky konfigurim mund të sugjerojë një shpërndarje të rolit ndërmjet subjekteve, ku njëri subjekt mban autorizimin dhe tjetri vepron si ofertues në procedurë, duke kufizuar në praktikë aksesin e operatorëve të tjerë në produktin përkatës dhe duke reduktuar konkurrencën efektive në tender.

Pa paragjykuar ekzistencën e një marrëveshjeje të ndaluar në kuptim të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, këto rrethana përbëjnë indicie të mjaftueshme për të kërkuar një vlerësim më të thelluar nga Autoriteti Kontraktor dhe, nëse është e nevojshme, nga autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen e konkurrencës, në mënyrë që të verifikohet nëse sjellja e subjekteve në fjalë ka ndikuar në deformimin e konkurrencës në këtë procedurë. Në çdo rast, ekzistenca e këtyre dyshimeve, e kombinuar me shkeljet e tjera të evidentuara në vlerësimin e ofertave, forcon konkluzionin se procedura nuk ka garantuar një garë reale dhe të hapur dhe për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet e zhvilluar në përputhje me parimet themelore të prokurimit publik. Së treti, është shkelur parimi i proporcionalitetit, i cili kërkon që masat e marra nga Autoriteti Kontraktor të jenë të përshtatshme, të nevojshme dhe të balancuara në raport me qëllimin që synohet të arrihet. Skualifikimi i një operatori për mungesë të një autorizimi formal, në një situatë ku procedura për pajisjen me këtë autorizim është ndikuar nga vonesa dhe praktika të diskutueshme të administratës përgjegjëse, përbën një masë disproporcionale, veçanërisht kur kjo masë shoqërohet me tolerimin e mangësive thelbësore në ofertën e operatorit tjetër. Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktor ka zbatuar një standard formalist dhe të ngurtë ndaj një operatori, ndërkohë që ka adoptuar një qasje fleksibile dhe tolerante ndaj një operatori tjetër, duke krijuar një disproporcion të dukshëm në trajtimin e situatave të krahasueshme.

Së katërti, është cenuar parimi i transparencës dhe i arsyetimit të vendimmarrjes. Vendimi për kualifikimin e operatorit Egian Med sh.p.k. nuk reflekton një analizë të plotë dhe të argumentuar të përputhshmërisë së ofertës me specifikimet teknike, duke mos adresuar në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar mungesën e efikasitetit të provuar ndaj gjinisë

Anopheles. Mungesa e një arsytimi të tillë tregon se vlerësimi nuk është bazuar në një shqyrtim real dhe të thelluar të dokumentacionit, por në një qasje formale dhe të pjesshme.

Në të njëjtën kohë, mënyra se si është trajtuar oferta e shoqërisë NRG sh.p.k., pa marrë në konsideratë rrethanat konkrete që lidhen me procedurën e autorizimit dhe pa reflektuar mbi ndikimin e këtyre rrethanave në aftësinë e saj për të përmbushur kërkesat formale, tregon për mungesë të një vlerësimi të balancuar dhe objektiv.

Në tërësi, analiza e të gjitha këtyre elementeve çon në përfundimin se procedura e prokurimit nuk ka garantuar një proces të drejtë, të paanshëm dhe konkurrues, por ka prodhuar një rezultat të paracaktuar në praktikë, ku operatori që nuk përmbush kërkesat teknike është kualifikuar, ndërsa operatori tjetër është përjashtuar mbi baza formale.

Ky deformim i mekanizmit të vlerësimit të ofertave përbën një cenim të rëndë të interesit publik, pasi çon në përzgjedhjen e një oferte që nuk garanton përmbushjen e plotë të objektit të kontratës dhe rrezikon efikasitetin e përdorimit të fondeve publike. Në këto kushte, procedura e zhvilluar nuk mund të konsiderohet në përputhje me ligjin dhe me parimet themelore të prokurimit publik, duke imponuar nevojën për ndërhyrje korrigjuese nëpërmjet shfuqizimit të vendimeve të marra dhe anulimit të procedurës në tërësi.

Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 Për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të kryejë një vlerësim objektiv, të paanshëm dhe të plotë të ofertave, në përputhje me kriteret dhe specifikimet e përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit. Në rastin konkret, ky detyrim ligjor nuk është respektuar, pasi nuk është verifikuar në mënyrë objektive dhe të plotë përputhshmëria e produkteve AQUABAC me specifikimet teknike të kërkuara, veçanërisht në lidhje me efikasitetin e provuar ndaj të gjitha specieveve target. Në mënyrë të veçantë, është neglizhuar mungesa e provës së efektivitetit për një specie thelbësore si Anopheles, e cila përbën një element kyç të kërkesave teknike të procedurës. Ky element nuk është analizuar dhe vlerësuar në mënyrë të plotë, duke çuar në një vlerësim të pasaktë dhe të njëanshëm të ofertës së operatorit ekonomik Egian Med sh.p.k.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktor është mjaftuar me ekzistencën e një autorizimi formal të produktit biocid, pa kryer verifikimin e pavarur dhe substancial të përputhshmërisë së tij me kërkesat konkrete të procedurës, në kundërshtim me detyrimin që rrjedh nga neni 77 për një vlerësim të plotë dhe real të ofertës.

Në vijim, vemë theksin në faktin se referuar praktikës së konsoliduar të Komisionit të Prokurimit Publik legjitimiteti për paraqitjen e ankimit nuk lidhet domosdoshmërisht me mundësinë e shpalljes fitues të operatorit ankues, por me ekzistencën e një interesi të ligjshëm për të kundërshtuar një procedurë të zhvilluar në kundërshtim me ligjin dhe që cenon parimet themelore të prokurimit publik.

Në këtë kuptim, shoqëria jonë, pavarësisht se është skualifikuar në këtë procedurë, gëzon interes të ligjshëm për të paraqitur ankim, pasi pretendimet e ngritura nuk synojnë përfitim individual apo rivlerësimin e ofertës sonë, por konstatimin e paligjshmërisë së procedurës në tërësi. Konkretisht, në linjë me arsyetimin e përdorur nga KPP në praktikën e tij, edhe në rastin konkret rezulton se Autoriteti Kontraktor ka kualifikuar një operator ekonomik që nuk përmbush kërkesat thelbësore të specifikimeve teknike të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit, duke sjellë si pasojë një vlerësim të pasaktë të ofertave dhe një deformim të konkurrencës.

Në këto kushte, shkëlja nuk është e kufizuar në një vlerësim të gabuar individual, por prek vetë mënyrën e zhvillimit të procedurës, pasi kriteret e vendosura nuk janë zbatuar në mënyrë të njëjtë dhe të paanshme për të gjithë operatorët ekonomikë.

Për rrjedhojë, duke iu referuar të njëjtit standard arsyetimi të ndjekur nga KPP, kur konstatohet se një operator është kualifikuar pa përmbushur kriteret e kërkuara, kjo sjell si pasojë pavlefshmërinë e procesit të vlerësimit dhe cenon ligjshmërinë e procedurës në tërësi. Në këtë situatë, procedura nuk mund të korrigjohet përmes një rivlerësimi të thjeshtë, pasi deformimi i konkurrencës dhe aplikimi i standardeve të dyfishta kanë ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin e saj.

Në këtë mënyrë, synohet rivendosja e ligjshmërisë dhe garantimi i një procesi konkurrues të drejtë, transparent dhe të paanshëm për të gjithë operatorët ekonomikë.

Për sa më sipër, kërkojmë:

? Pranimin e ankimit si të bazuar në ligj dhe në prova;

? Shfuqizimin e vendimit të Autoritetit Kontraktor për kualifikimin e operatorit ekonomik Egian Med shpk;

? Skualifikimin e operatorit ekonomik Egian Med, për mosplotësim të specifikimeve teknike thelbësore të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit;

? Anulimin e procedurës së prokurimit, si e zhvilluar në kundërshtim me ligjin dhe parimet themelore të prokurimit publik, për shkak të deformimit të konkurrencës dhe vlerësimit të njëanshëm të ofertave;

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1161/2 prot., datë 17.04.2026.

II.7. Me datë 22.04.2026 operatori ekonomik “Egian Med” SHPK në cilësinë e subjektit të interesuar ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike formularin e argumentave i cili u protokollua me tonën me nr. 1161/3 prot., datë 22.04.2026.

II.8. Nëpërmjet shkresës datë 27.04.2026, me objekt “Kundërshtim/Ankimim në KPP në vijim të vendimit të KSHA date 27.4.2026”, protokolluar me tonën me nr. 1161/4 prot., datë 28.04.2026, operatori ekonomik “NRG” SHPK ka paraqitur pranë KPP-së argumenta kundërshtues.

II.9. Me datë 04.05.2026, autoriteti kontraktor nëpërmjet shkresës nr. 2117/2 prot., datë 28.04.2026 me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “NRG” shpk, lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr. REF-76061-02-12-2026, me objekt: Loti 2 “Shërbim dezinsketimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Tiranë” ka dorëzuar pranë KPP-së, vendimin e KSHA nr. 65/2026 datë 28.04.2026 për shqyrtimin e ankesës i cili u protokollua me tonën me nr. 1161/5 prot., datë 04.05.2026 nga ku rezultoi se ka vendosur refuzimin e saj duke argumentuar ndër të tjera:

[...]

Një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislativi janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase, të ndonjë veprimi tjetër zyrtar apo mosveprimi nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dëshon në sa më sipër, atëherë ankimi është i papranueshëm.

Neni 109, pika 1 kërkon shprehimisht që ankuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në AK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Sikurse në rastin konkret, operatori ekonomik ankimues nuk e pretendon në asnjë moment kualifikimin e ofertës së tij, duke e pranuar gjendjen faktike të vlerësimit dhe rrjedhimisht duke qëndruar në statusin i skualifikuar. Edhe në hipotezën se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij, në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, ankimesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit të ankesës, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi. KSHA gjykon se një operator ekonomik nuk ka interes të ligjshëm për të ankimuar kualifikimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurë nëse ai nuk ka kërkuar kualifikimin e ofertës së tij apo nuk është skualifikuar padrejtësisht. Interesi i ligjshëm lind vetëm kur një vendim i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave prek drejtpërdrejtë të drejtën e operatorit për tu shpallur fitues. Për të pasur të drejtë ankimi, operatori ekonomik duhet të ketë paraqitur një ofertë të rregullt dhe është skualifikuar nga procedura e prokurimit. KSHA gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk ka arritur të dëshmojë një lidhje direkte mes shkëljes së pretenduar dhe mospërfitimit të kontratës. Sa më sipër KSHA gjykon se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “NRG” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Egian Med” shpk nuk do të merren në shqyrtim, pasi gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik ankimues “NRG” shpk do të vijojë të ngelet e skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt ankimi, e rrjedhimisht pa ndonjë interes për vetë ankimesin. [...]

II.10. Me anë të shkresës nr. 17 prot., datë 28.04.2026, protokolluar me tonën me nr.546/11 prot., datë 30.04.2026, operatori ekonomik “NRG” SHPK ka dorëzuar pranë KPP-së shkresën me objekt “Dërgim informacioni lidhur me efektivitetin e produktit Aquabac (Aquabac DF 3000, Aquabac 200 dhe Aquabac XT)”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “NRG” SHPK mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe me kërkesën për anulimin e procedurës, Komisioni i Prokurimit Publik para shqyrtimit në themel të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, konstaton se ky i fundit nuk gëzon interes të ligjshëm në këtë procedurë prokurimi.

III.1.1. Në datën 31.03.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “NRG” sh.p.k	22,511,376 lekë	skualifikuar
2. “Egian Med” shpk	22,846,944 lekë	kualifikuar
3. “Loerma” SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike	
4. “Alpest” SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike	

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik me datë 08.04.2026, rezulton se është publikuar në SPE Njoftimi i Fituesit Paraprak.

III.1.3. Në nenin 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

III.1.4. Në nenin 109 pika 1 “E drejta e ankimit” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi sipas LPP dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit ose entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.5. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin Elektronik të Ankesave”.

III.1.6. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në sistemin e ankesave

elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.1.7. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.8. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues “NRG” SHPK, informacionit të autoritetit kontraktor si dhe verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton se autoriteti kontraktor në datë 31.03.2026 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, ku operatori ekonomik “NRG” SHPK, rezulton i skualifikuar, ndërsa operatori ekonomik “Egian Med” SHPK rezulton si operatori i vetëm i kualifikuar në këtë procedurë prokurimi. Gjithashtu, në datë 08.04.2026, është publikuar njoftimi i fituesit paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, prej së cilës rezulton fitues operatori ekonomik “Egian Med” SHPK. Në datën 16.04.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6542 dhe nr. 1161/1/2026 prot., datë 16.04.2026 e operatorit ekonomik “NRG” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit ku u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Egian Med” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe me kërkesën për anulimin e procedurës, por nuk ka ngritur asnjë pretendim për sa i përket skualifikimit të tij në këtë procedurë.

Në interpretim literal, sistematik dhe teleologjik me synim vendosjen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 109 pika 1 “E drejta e ankimit” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe neni , 94, pika 1 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar kërkojnë shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes të ligjshëm, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatori ekonomik ankimues është njoftuar në përputhje me parashikimet e ligjit për prokurimin publik në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë autoritetit kontraktor i cili ka vendosur për skualifikimin e ofertës së këtij të fundit, por kualifikimin e operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK. Brenda afateve të parashikuara të ankimit në nenin 110 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ankimuesi ka parashtruar pretendime vetëm mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK si dhe mbi anulimin e procedurës dhe jo mbi skualifikimin e tij nga kjo procedurë prokurimi. Ligjvënësi në nenin 110 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ka parashikuar afate

strikte mbi paraqitjen e ankesës, afate të cilat për nga natyra juridike janë prekluzive. Kështu, pas përfundimit të afatit të ankimit të vendosur në ligj, në kushtet kur operatori ekonomik NRG” SHPK nuk ka pasur pengesë në ushtrimin e të drejtës së ligjshme të ankimit, vendimi i autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së tij është përfundimtar dhe nuk mund të rishikohet nga një organ tjetër administrativ. Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative: (legjitimimi *locus standi*), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për tu dëmtuar nga një shkelje e pretenduar. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues rezulton i skualifikuar me një vendim përfundimtar nga autoriteti kontraktor për të cilën ky i fundit nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit por ka ushtruar të drejtën e ankimit për operatorin tjetër pjesëmarrës të kualifikuar në këtë procedurë, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin për operatorin ekonomik “NRG”, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se nuk ka paraqitur pretendime në ankesë mbi skualifikimin e tij se në çfarë mënyre autoriteti kontraktor në saj të vendimmarrjes i ka cënuar të drejtat e mbrojtura nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se LPP parashikon në mënyrë eksplicite, se për çdo vendimmarrje të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë që rrezikojnë të dëmtohen nga ky vendim duhet të ushtrorjnë të drejtën e tyre të ankimit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik brenda afateve të parashikuara në LPP, duke respektuar të gjitha elementet formale sipas dispozitave ligjore. Referuar përcaktimeve ligjore si më sipër cituar, kërkohet që ankimuesi, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të rregullohet përmes ankimit pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është, që përmes ankimit ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit sepse në ankesë nuk ka paraqitur pretendime lidhur me skualifikimin e tij, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën duke mos gëzuar asnjë interes të ligjshëm në këtë procedurë prokurimi në kuptim të nenit 109 pika 1 “E drejta e ankimit” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe neni 94, pika 1 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorin “Egian Med” SHPK do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës pasi sipas vendimit të KVO ai rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit dhe në ankesën e paraqitur në KPP dhe autoritet kontraktor ai nuk ka paraqitur pretendime mbi këtë fakt. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin, vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*), nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “NRG” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK dhe për anulimin e procedurës së prokurimit nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e e paraqitur nga ankimuesi “NRG” SHPK për procedurën e e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-76061-02-12-2026, me objekt: “Loti 2: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Tiranë”, me fond limit 23,531,592 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
 2. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “NRG” SHPK
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

